



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/23

Datë: 13.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, Paragrafi 1, i Ligji Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në pajtim me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023 i aprovuar me Vendimin e Qeverisë nr. 01/02 datë 05.06.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M


1. Aprovohet Plani për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike në vlerë prej treqind e gjashtë dhjetë e pesë milion euro (365,000,000.00 €), sipas shtojcës së këtij vendimi, me masat dhe shumatat si në vijim:
 - 1.1. **MASA 1** - Lehtësimi i qasjes në kredi për ndërmarrjet private, për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit, në vlerë prej njëqind milion euro (100,000,000.00 €), me aktivitete si në vijim:
 - 1.1.1. **MASA 1A** - Rritja e mbulueshmërisë së kredive të reja përmes Fondit Kosovar për Garanci të Kredive, në vlerë prej gjashtëdhjetë milion euro (60,000,000.00 €);
 - 1.1.2. **MASA 1B** - Mbulimi i kostos së tarifës së Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, në vlerë prej pesë milion euro (5,000,000.00 €);
 - 1.1.3. **MASA 1C** - Ri-programimi i kredive bankare ekzistuese, ku koston e ri-programimit e merr Qeveria, në vlerë prej tridhjetë milion euro (30,000,000.00 €); dhe
 - 1.1.4. **MASA 1D** - Subvencionimi i normave të interesit për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga akterët relevantë, në vlerë prej pesë milion euro (5,000,000.00 €).
 - 1.2. **MASA 2** - Lehtësimi i barrës tatimore të bizneseve, për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtër, në vlerë prej pesëmbëdhjetë milion euro (15,000,000.00 €);
 - 1.2.1. **MASA 2A** - Shtyrje e pagesës së tatimeve bazuar në nevojat e bizneseve;
 - 1.2.2. **MASA 2B** - Mbulimi i pesë përqindëshit (5%) të kontributit pensionale që biznesi paguan për punëtorë, në vlerë prej pesë milion euro (5,000,000.00 €);
 - 1.2.3. **MASA 2C** - Pushimet tatimore për firmat për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga akterët relevantë;
 - 1.2.4. **MASA 2D** - Lirimet për parapagimet e obligimeve tatimore nga ana e bizneseve;

- 1.2.5. **MASA 2E** - Lirimi i bizneseve nga ndëshkimet tatimore për vonesa në pagesën e tatimeve për shkak të pandemisë bazuar në kritere të qarta dhe transparente;
- 1.2.6. **MASA 2F** - Ofrimi i mundësisë për ri-programim të borxheve tatimore të mëparshme, duke përfshirë edhe zbritjet për pagesën e menjëhershme të borxhit; dhe
- 1.2.7. **MASA 2G** - Subvencionimi i pesëdhjetë për qind (50%) të shpenzimeve të qirasë për biznese, në vlerë prej dhjetë milion euro (10,000,000.00 €).
- 1.3. **MASA 3** - Rritja e punësimit, në veçanti e grupeve specifike të punëtorëve me gjasa më të ulëta për punësim në vlerë prej gjashtë dhjetë e shtatë milion e treqind mijë euro (67,300,000.00 €);
 - 1.3.1. **MASA 3A** - Subvencionim i pagës për punëtorët në biznese të prekur nga pandemia për muajin Mars dhe Prill (170 Euro), në vlerë prej dyzet e shtatë milion e treqind mijë euro (47,300,000.00 €);
 - 1.3.2. **MASA 3B** - Subvencionim i pagës për punëtorët e rinj që marrin bizneset në punë bazuar në një plan që identifikon sektorët dhe kategorinë e punëtorëve më në nevojë, në vlerë prej pesë milion euro (5,000,000.00 €);
 - 1.3.3. **MASA 3C** - Përkrahja profesionale për biznese për funksionim në kushte pandemie, siç është puna nga shtëpia, puna online, transformimi digjital etj., në vlerë prej tre milion euro (3,000,000.00 €);
 - 1.3.4. **MASA 3D** - Përkrahja e bizneseve prodhuese dhe shërbyese me pajisje dhe makineri për automatizim të proceseve, në vlerë prej dhjetë milion euro (10,000,000.00 €); dhe
 - 1.3.5. **MASA 3E** - Përkrahja e bizneseve me qëllim rritjen e produktivitetit të tyre, në vlerë prej dy milion euro (2,000,000.00 €).
- 1.4. **MASA 4** - Rritja e prodhimit bujqësor vendor, për të rritur punësimin në zonat rurale, për të zvogëluar importin e produkteve bujqësore, për të tejkaluar sfidat nga mungesa e shitjeve shkaktuar nga COVID-19 dhe për të rritur sigurinë e ushqimit - në vlerë prej njëzetë e gjashtë milion euro (26,000,000.00 €);
 - 1.4.1. **MASA 4A** - Dyfishimi i buxhetit për Programin për Pagesat Direkte vetëm për vitin 2020, në vlerë prej njëzetë e katër milion euro (24,000,000.00 €); dhe
 - 1.4.2. **MASA 4B** - Subvencionimi i normave të interesit të kredive në bujqësi, në vlerë prej dy milion euro (2,000,000.00 €).
- 1.5. **MASA 5** - Stimulimi i kërkesës agregate, e cila nxit prodhimin dhe punësimin me efekte multiplikuese në ekonomi, në vlerë prej pesëmbëdhjetë milion euro (15,000,000.00 €);
 - 1.5.1. **MASA 5A** - Lejimi i tërheqjes së shumës prej 10% të mjeteve të kursyera në Trustin Pensional për kontribut-paguesit, bazuar në nevojat e tyre, e cila mundësi mund të shfrytëzohet për një periudhë 4-mujore; dhe
 - 1.5.2. **MASA 5B** - Mbështetje për zgjatjen e greis periudhës për blerje të banesave dhe shtëpive bazuar në kritere të të ardhurave, në vlerë prej pesëmbëdhjetë milion euro (15,000,000.00 €).
- 1.6. **MASA 6** - Mbështetje e operimit dhe investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike, në veçanti ato investime që janë të natyrës strategjike, që të përballojnë uljen e të hyrave nga inkasimi dhe investimet e nevojshme kapitale që duhet të ndërmarrin në vlerë prej shtatëmbëdhjetë milion euro (17,000,000.00 €);

- 1.6.1. **MASA 6A** - Mbulimi i kostove minimale operative të ndërmarrjeve publike, në vlerë prej katërbëdhjetë milion euro (14,000,000.00 €);
- 1.6.2. **MASA 6B** - Rishikim i planit dinamik të investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike dhe vlerësimin i investimeve të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve publike; dhe
- 1.6.3. **MASA 6C** - Mbështetje e investimeve të ndërmarrjeve publike përmes subvencionimit nga buxheti, huadhënies nga buxheti dhe lëshimit të garancioneve sovrane për kreditë që ndërmarrjet publike marrin institucionet financiare, në vlerë prej tre milion euro (3,000,000.00 €).
- 1.7. **MASA 7** - Mbështetje financiare për punësimin e të rinjve, përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile, grupeve tjera jo formale, stimulimit të aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe ri-vitalizimit të tyre, në vlerë prej pesë milion euro (5,000,000.00 €);
- 1.8. **MASA 8** - Mbështetje për programe ekzistuese dhe të reja që lidhen me zhvillimin rajonal përmes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, që ndikojnë në zhvillim të balancuar rajonal në vlerë prej dy milion euro (2,000,000.00 €);
- 1.9. **MASA 9** - Mbështetje komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e jetës dhe rigjallërimin ekonomik të tyre, në vlerë prej dy milion euro (2,000,000.00 €);
- 1.10. **MASA 10** - Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi, në vlerë prej dy milion euro (2,000,000.00 €);
- 1.11. **MASA 11** - Mbështetje e sektorit të arsimit për të mundësuar fillimin dhe mbarëvajtjen me sukses të mësimin gjatë vitit shkollor 2020/2021, në vlerë prej dhjetë milion euro (10,000,000.00 €);
- 1.12. **MASA 12** - Mbështetje për komunat e Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, në vlerë prej dhjetë milion (10,000,000.00 €);
- 1.13. **MASA 13** - Mbështetje financiare për bashkatdhetarët duke mbuluar koston e primit të policës së sigurimit, në vlerë prej tre milion (3,000,000.00 €);
- 1.14. **MASA 14** - Financimi (rimbursimi i linjave buxhetore) për zbatimin e masave të vendimit Nr. 01/19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në vlerë prej shtatëdhjetë e një milionë e shtatëqind mijë euro (71,700,000.00 €); dhe
- 1.15. **MASA 15** - Kontigjencë për emergjencë - Kontigjencë mbahet për raste emergjente për përballim më të mirë të pandemisë COVID-19, në vlerë prej nëntëmbëdhjetë milion euro (19,000,000.00 €);
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij vendimi, përjashtimisht Masës 3A sipas pikës 1.3.1 si dhe Masës 13, sipas pikës 1.13, ndahen me vendim të veçantë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bazë të propozimeve dhe planeve të ministrive të linjës, sipas prioriteteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, disponueshmërisë së mjeteve dhe burimeve të financimit, në kuadër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike, sipas nenit 24A të Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.
3. Alokimi i mjeteve të ndara sipas pikës 2. të këtij vendimi bëhet në mënyrë graduale te ministritë e linjës të ngarkuar për zbatim të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, në përputhje me rjedhën e parasë dhe dinamikën e zbatimit të masave të përcaktuara në Programin e Rimëkëmbjes Ekonomik.

4. Të gjitha mjetet për realizimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike që ndërlidhen me subvencionimin e normave të interesit apo tarifave bankare ndaj institucioneve kredi dhënëse të licencuara nga BQK, do të ndahen te Thesari i Kosovës (MF), me qëllim të përcaktuar, në emër dhe për llogari të ministrive përkatëse zbatuese të masave të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, në të cilat parashihet një aktivitet i tillë.
5. Me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, obligohen të gjitha ministrinë përgjegjëse për zbatimin e masave sipas Shtojcës së këtij vendimi, të përgatisin planet, udhëzimet dhe kriteret sektoriale për zbatimin e masave, me të cilat kërkohet ndarja buxhetore sipas pikës 2. të këtij vendimi.
6. Zotimi i mjeteve, përkatësisht hyrja në obligime për zbatimin e masave të këtij vendimi bëhet vetëm pasi të ndahen dhe alokohen mjetet buxhetore në programet përkatëse në ministrinë e linjës sipas pikës 2. dhe 3. të këtij vendimi.
7. Mjetet që ndahen në zbatim të këtij vendimi, përdoren ekskluzivisht për zbatimin e masave të përcaktuara në Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike.
8. Në rast se shuma e mjeteve të aprovuara për zbatimin e masave sipas pikës 2. të këtij vendimi rezulton në tepriçë, mjetet ri destinohen me vendim të Qeverisë për financimin e masave tjera brenda Programit të Rimëkëmbjes ekonomike.
9. Obligohen të gjitha ministrinë përgjegjëse për implementimin e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
10. Obligohet Ministria e Financave që pas pranimit të kërkesave nga ministrinë përgjegjëse për zbatim të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike, të procedojë në Qeverinë e Republikës së Kosovës propozim vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore, në pajtim me pikën 2. të këtij vendimi.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojcë:

PLANI OPERACIONAL PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE

Programi për Rimëkëmbje Ekonomike, i cili derivon nga Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023, i aprovuar në Qeveri më 5.6.2020 me nr.01/02, ka për qëllim ruajtjen e shëndetit publik dhe ekonomik të vendit. Pasi që COVID-19 tashmë ka shkaktuar një dëm të konsiderueshëm ekonomik, duke ndikuar negativisht në prodhim, punësim, të ardhura dhe eksporte, këto masa dhe ky program kanë për qëllim përshpejtimin e rimëkëmbjes ekonomike. Në këtë fazë, kemi filluar të vërejmë edhe ndikimin negativ të efekteve multiplikuese, që reflektohen përmes rënies së investimeve dhe konsumit si dy prej komponentëve kryesor të kërkesës agregate.

Masat për rimëkëmbje ekonomike janë bazuar në një analizë të përgjithshme të ndikimit ekonomik të COVID-19. Këto masa janë përmbledhur në kuadër të "Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike". Me rishikimin e Ligjit për Buxhetin 2020, është krijuar program i veçantë, Programi për Rimëkëmbjen Ekonomike pas, ku janë alokuar mjetet që do të dedikohen për qëllime të mbështetjes ekonomike dhe sociale për të tejkaluar pasojat e pandemisë.

Pandemia ka ndikuar negativisht ofertën agregate dhe po ashtu ka ndikuar në rënie signifikante të kërkesës agregate. Prandaj, do të ndërmerren masa të menjëhershme që sa më parë, të normalizohet funksionimi i aktivitetit ekonomik, por duke respektuar udhëzimet shëndetësore që të parandalohet përhapja e virusit. Krahas normalizimit të funksionimit të ekonomisë, do të ofrohet mbështetje e menjëhershme financiare për bizneset, për të përballuar kostot minimale të operimit dhe mbijetesës gjatë kësaj periudhe. Këto masa do të parandalojnë daljen e bizneseve nga tregu, duke siguruar që kostot ekonomike dhe sociale të pandemisë të jenë më të ulëta, si për bizneset dhe familjet ashtu edhe për shtetin.

Masat për rimëkëmbje ekonomike

Masat për rimëkëmbje ekonomike, që janë paraqitur në tabelën në vijim, do të sigurojnë rimëkëmbje ekonomike kah fundi i këtij viti dhe viti vijues, duke supozuar që situata pandemike fillon të përmirësohet. Këto masa do të mobilizojnë të gjitha burimet e financimit për bizneset. Do të punohet me Fondin Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK) që financimi afatgjatë për biznese të rrjedhë kryesisht përmes bankave dhe me kushte më të mira të financimit. Përmes kanalizimi të fondeve në ekonomi aty ku ka nevojë dhe ku efekti është maksimal, do të krijohet një momentum të ri për zhvillim të hovshëm ekonomik, duke e vendosur ekonominë e Kosovës fillimisht aty ku ishte para pandemisë e më pas të gjenerojmë rritje në një trajektore më të lartë të rritjes dhe zhvillimit afatgjatë, me punësim më të lartë dhe të qëndrueshëm.

Masa	Qëllimi i masës dhe përshkrimi	Nënmasa	Buxheti – kosto direkte nga Fondi për Rimëkëmbje Ekonomike	Kosto indirekte për buxhetin e shtetit	Mekanismi/ institucioni i zbatimit	Komente
1. Lehtësimi i qasjes në financim	Lehtësimi i qasjes në kredi për ndërmarrjet private, për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit.	a. Rrëzja e mbulueshmërisë së kredive të reja përmes Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK),	60 mil	-	MF, FKGK dhe BQK	20 mln prej IDA/IBB (të rafinuar)
		b. Mbulimi i kostos së tarifës së FKGK	5 mil	-	MF, FKGK dhe BQK	FKGK dhe BQK, për mbulimin e tarifës së FKGK
		c. Riprogramimi i kredive bankare ekzistuese, ku koston e riprogramimit e merr Qeveria	30 mil	-	MF dhe BQK	Këto mjete përdoren për të paguar normën e interesit për tre muaj, për shlyrje të kështjave për individë dhe biznese.
		d. Subvencionimi i normave të interesit për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga aktorët relevantë	5 mil	-	MTI përgatitë kriteret ku përcaktohen sektorët dhe kushtet për bizneset përfituese nga kjo masë. MF, përmes Thesarit, bën mbulimin e normave të interesit sipas kriterëve të përcaktuara nga MTI	
2. Zvogëlimi i barrës tatimore	Lehtësimi i barrës tatimore të bizneseve, për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtyr.	a. Shlyrje e pagesës së tatimeve bazuar në nevojat e bizneseve	-	-	MF/ATK përgatitë aktin nënligjor për riprogramimin e obligimeve tatimore bazuar në nevojat e bizneseve	
		b. Mbulimi i 5-përqindëshit të kontributit pensionale që biznesi paguan për punëtorë	5 mil	-	MTI dhe MF/ATK përgatitë aktin nënligjor ku përcaktohet kriteret për përfitim të bizneseve nga kjo masë, bazuar në kushtet e biznesit.	

3. Masat për mbështetje të punësimit	Rritja e punësimit, në veçanti e grupeve specifike të punëtorëve me gjasa më të ulëta për punësim.	c. Pushimet tatimore për firmat për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga aktorët relevantë	-	3 mi në vit	MF/ATK përgatit aktin nënligjor për pushime tatimore bazuar në Ligjin për të Ardhurat e Korporatave	
		d. Lirimet për parapagimet e obligimeve tatimore nga ana e bizneseve	-	20 mi	MF/ATK përgatit aktin nënligjor	
		e. Lirimi i bizneseve nga ndëshkimet tatimore për vonesa në pagesën e tatimeve për shkak të pandemisë bazuar në kritere të qarta dhe transparente	-	10 mi	MF/ATK përgatit aktin nënligjor	
		f. Ofrimi i mundësisë për riprogramim të borxheve tatimore të mëparshme, duke përfshirë edhe zbritjet për pagesën e menjëhershme të borxhit.	-	10 mi	MF/ATK përgatit aktin nënligjor	
		g. Subvencionimi i 50% të shpenzimeve të qirasë për biznese	3 milion janë ekzekutuar) 7 milion në proces të ekzekutimit		MEA	
	a. Subvencionim i pagës për punëtorët në biznese të prekura nga pandemia për muajt Mars dhe Prill (170 Euro).	24 milion janë ekzekutuar) 25.3 milion në proces të ekzekutimit	MEA			
	b. Subvencionim i pagës për punëtorët e rinj që marrin bizneset në punë bazuar në një plan që identifikon sektorët dhe kategorinë e punëtorëve më në nevojë.	5 milion (prej të cilave 1.8 milion janë ekzekutuar)	MPMS përgatit kritere të përfundimtarë të bizneseve nga kjo masë me rastin e punësimit të punëtorëve nga lista e të papunëve			

		<p>c. Përkrahja profesionale për biznese për funksionim në kushte pandemike, siç është puna nga shërbëja, puna online, transformimi digital etj.</p> <p>d. Përkrahja e bizneseve prodhuese dhe shërbëse me pajisje dhe makineri për automatizim të proceseve</p> <p>e. Përkrahja e bizneseve me qëllim rritjen e produktivitetit të tyre</p>	3 mil		<p>MTI përgatit kriteret e përfundim të bizneseve nga kjo masë</p> <p>MTI përgatit kriteret e përfundim të bizneseve nga kjo masë</p> <p>MTI përgatit një Program dhe kriteret për zbatimin e masës</p>	
4. Bujqësi	<p>Rritja e prodhimit bujqësor vendor, për të rritur punësimin në zonat rurale, për të zvogëluar importin e produkteve bujqësore, për të tejkaluar sfida nga mungesa e shitjeve shkaktuar nga COVID-19 dhe për të rritur sigurinë e ushqimit – në vlerë prej njëzetë e gjashtë milion euro</p>	<p>a. Dyfishimi i buxhetit për Programin për Pagësat Direkte për vitin 2020.</p> <p>b. Subvencionimi i normave të interesit të kredive në bujqësi.</p>	24 mil	2 mil	<p>MBPZ/HR përshtatë kriteret për zbatim në përputhje me Programin për Rimbëmbje Ekonomike (PRE)</p> <p>MBPZ/HR përgatit kriteret ku përcaktohen sektorët dhe kushtet për bizneset përfituese nga kjo masë. MF, përmes Thesarit, bën mbulimin e normave të interesit sipas kriterëve të përcaktuar.</p>	
5. Masat për stimulim të kërkesës agregate	<p>Rritja e shpenzimeve të konsumatorëve, e cila nxit prodhimin dhe punësimin me efektë multiplikuese në ekonomi.</p>	<p>a. Lejimi i tërheqjes së shumës prej 10 % të mjeteve të kursyera në Trustin Pensional për kontrat-paguesit, bazuar në nevojat e tyre, e cila mundësi mund të shfrytëzohet për një periudhë 4-mujore</p>	-	-	<p>MF, BQK dhe Trusti Pensional bëjnë përgatitjet e nevojshme dhe fillojnë zbatimin sapo të miratohet ligji për rimbëmbje ekonomike. Rreth 170 mil euro pritet të hyjnë në ekonomi.</p>	

	b. Mbështetje për zgjatjen e greis periodhës për blerjet të banesave dhe shtëpive bazuar në kriteret të të ardhurave.	15 mil		MF së bashku me BOK dhe bankat komerciale përcaktojnë kushtet dhe kriteret për mbulimin e kostove të normës së interesit për gjatë greis periodhës për dy vite për blerjet e shtëpive/banesave.	
6. Mbështetje për ndërmarrje publike për operim të rrëgjullt dhe investime kapitale të rëndësishë strategjike	Mbështetje e operimit dhe investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike, në veçanti ato investime që janë të natyrës strategjike, që të përballojnë uljen e të hyrave nga inkasimi dhe investimet e nevojshme kapitale që duhet të ndërmarrin.	<p>a. Mbulimi i kostove minimale operative të ndërmarrjeve publike.</p> <p>b. Rishikim i planit dinamik të investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike dhe vlerësimin i investimeve të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve publike.</p>	14 mil	<p>MEA</p> <p>14 mil kredi nga BERZH</p> <p>MEA përgatit plan strategjik investiv për ndërmarrje publike bazuar në planin e biznesit përsëjçare të ndërmarrjeve publike</p>	
	c. Mbështetje e investimeve të ndërmarrjeve publike përmes subvencionimit nga buxheti, huadhënies nga buxheti dhe kështu në garancioneve sovrane për kreditë që ndërmarrjet publike marrin institucionet financiare	3 mil	300 mil	MEA ndan këto mjete bazuar në planin investiv të ndërmarrjeve publike.	
7. Kultura, Rinia dhe Sporti	Mbështetje financiare për punësimin e të rinjve, përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile, grupeve tjera jo formale, stimulimi të aktiviteve kulturore, artistike, sportive dhe ri-vitalizimit të tyre	5 mil	-	MKRS përgatit kriteret ku përcaktohen sektorët/institucionet dhe kushtet për përfitim nga kjo masë.	

8. Mbeshtetje për programe të zhvillimit rajonal	Mbeshtetje për programe ekzistuese dhe të reja që lidhen me zhvillimin rajonal përmes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, që ndikojnë në zhvillim të balancuar rajonal.	a. Mbeshtetje për programin e zhvillimit rajonal në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, me qëllim të ndihmës për rajone më të ndikuara nga pandemia	2 mil	-	Ministria e Zhvillimit Rajonal përgatit kriteret ku përcaktohen veprimet specifike për përfitim nga kjo masë.	
9. Mbeshtetje për komunitete jo shumicë	Mbeshtetje komunitetve jo shumicë në Republikën e Kosovës, për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e jetës dhe rigjallërimin ekonomik të tyre	b. Mbeshtetje komunitetve për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e jetës dhe rigjallërimin ekonomik	2 mil	-	ZKM/Zyra për komunitet përgatit kriteret ku përcaktohen sektorët/institucionet dhe kushtet për përfitim nga kjo masë.	
10. Mbeshtetje financiare për barazi gjinore	Mbeshtetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e pozitës së gruas në ekonomi	a. Mbeshtetje sektori të arsimit pas ndikimit të madh të pandemisë në mënyrën e organizimit të mësimdhënies	2 mil	-	ZKM/Zyra për Barazi Gjinore përgatit kriteret për ndarje të këtyre mjeteve. Bashkëpunohet ngushtë edhe me donatorë dhe partnerë zhvillimorë (siç është MCC) për të ndërtuar strategji të përbashkët në këtë drejtim.	
11. Mbeshtetje për sektorin e arsimit	Mbeshtetje e sektori të arsimit për të mundësuar fillimin dhe mbarevajtjen me sukses të mësimi gjatë vitit shkollor 2020/2021.	a. Mbeshtetje sektori të arsimit pas ndikimit të madh të pandemisë në mënyrën e organizimit të mësimdhënies	10 mil	-	MASH përgatit strategji ku përcaktohen kriteret dhe kushtet për fillim dhe mbarevajtje të suksesshëm të vitit akademik 2020/2021.	
12. Mbeshtetje për komunat e Kosovës	Mbeshtetje për komunat e Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19	a. Mbeshtetje financiare për mbulimin e shpenzimeve të krijuar gjatë menaxhimit të pandemisë	10 mil	-	MPL në bashkëpunim me komunat përgatit strategji ku përcaktohen kriteret dhe kushtet për Komunat për përfitim nga kjo masë.	29 milion shtesë përdoren nga komunat meqë ligji për paga në sektorin publik nuk ka hy në fuqi.

13. Mbledhjetje financiare për bashkatdhetarët	Mbledhjetje financiare për bashkatdhetarët duke mbuluar koston e primit të policisë së sigurimit për periudhën 1 gusht – 31 dhjetor 2020.	3 mil		Mjetelet mbahen në MF/Thesar dhe ndahen sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe vendimit të Qeverisë lidhur me këtë çështje.	
14. Financimi i masave të vendimit Nr. 01/19	Financimi i linjave buxhore për zbatimin e masave të vendimit Nr. 01/19 të Qeverisë së Kosovës	71.7 mil	-	MIA, MTL, MPV/S, MF	
15. Kontigjencë për emergjencat	Kontigjencat mbahet për raste emergjente për përballim në të cilkas dhe masa në të shpejta për luftimin e pandemisë COVID-19	19 mil	-	Mjetelet mbahen në MF dhe shfrytëzohen me vendime të qeverisë për situata emergjente sipas arsyetimit të Ministrisë së Shëndetësisë.	